

TAKIMI I PARË 2024 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Takimi i parë 2024 i Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u mbajt më datë **21.03.2024**.

Mbledhja u hap me diskutimin mbi zhvillimin e shpejtë të sektorit të mikpritjes dhe turizmit. Në mbledhje ishte e pranishme dhe Zëvendësministria e arsimit dhe formimit profesional, e cila në fjalën e saj theksoi se, problematika kryesore mbetej aftësia për të ndjekur ritmet e zhvillimit të tregut. Zëvendësministria tha se, sfida më e madhe ishte vlerësimi i mangësive që mund të ekzistojnë jo vetëm në sektorin e turizmit, por edhe në sektorët e tjerë. Gjithashtu, ajo evidentoi se, një nga problematikat kryesore ishte gjetja e forcës punëtore për të siguruar shërbim cilësor në fushën e turizmit. Zëvendësministria bëri të ditur se, po punohej për sigurimin e marrëveshjeve që do të mundësonin forcë punëtore nga shtete të tjera, ndërkohë që u theksua nevoja që bizneset të ishin të gatshme të ofronin kontrata pune një vjeçare.

Në vijim, u prezantuan rezultatet e gjetjeve nga Studimi i Nevojave për Aftësi (SNA) në fushën e mikpritjes dhe turizmit. Përfaqësuesja e HDKP-së (organizata që kishte kryer Studimin) bëri me dije se, Studimi ishte realizuar në bazë të ndarjes së zonave në tre pjesë: Tirana, zonat bregdetare dhe zonat e tjera. Përfaqësuesja e HDKP-së vuri në dukje se, turizmi zinte vendin e dytë për sa i përkonte peshës në ekonomi, pas bujqësisë, dhe se pas disa vitesh, me të njëjtin ritëm zhvillimi, mund të renditej në vendin e parë. Përfaqësuesja e HDKP-së theksoi se, investimet strategjike ishin shumë të rëndësishme në drejtimin e zhvillimit të turizmit. Megjithatë, ato ende nuk ishin reflektuar plotësisht si kontribute ekonomike dhe duhej punuar më shumë për këtë qëllim.

Përfaqësuesja e HDKP-së theksoi se, në Shqipëri, në atë moment, dy ishin qëllimet kryesore: promovimi i turizmit elitare dhe zhvillimi i një turizmi të qëndrueshëm. Për turizmin elitare, i cili mbështetej në investimet strategjike, u sqarua se, kërkonte kushte të caktuara dhe se rezultatet e studimit jepnin një indikacion shumë të qartë mbi seriozitetin e kësaj ambicieje.

Në vijim, përfaqësuesja e HDKP-së prezantoi gjetjet që rezultuan nga studimi. Ajo tha se, nga analiza e Studimit të Nevojave për Aftësi u konstatua se, kompanitë e mëdha ishin të pakta në numër, por me rëndësi të lartë për zhvillimin e ardhshëm. Ajo tha se, SNA kishte evidentuar që, rritja e pagës minimale kishte ndikuar pozitivisht në produktivitet, ndërkohë që sektori i turizmit mbetej pas në përthithjen e teknologjisë. Po kështu, SNA evidentonte se, Tirana kishte përqindjen më të lartë të të punësuarve, ku shumica ishin të angazhuar në sektorin e akomodimit dhe gjithashtu, një pjesë e madhe e bizneseve ishin familjare. Kjo gjë e vështirësonte procesin e trajnimit dhe digjitalizimit. Përfaqësuesja e HDKP-së tha se, SNA nxirrte në pah mungesën e madhe të fuqisë punëtore dhe aftësive të buta, veçanërisht në profesionet e Kamarierëve, Banakierëve dhe Sanitarëve. Nga studimi rezultonte se, Tirana kishte mungesën më të madhe të aftësive për shkak të fokusit në cilësinë e shërbimit. U vlerësua se, vetëm një përqindje e vogël e

punonjësve kishin marrë trajnim gjatë 12 muajve të fundit dhe u nënvizua nevoja për rritjen e fleksibilitetit të kurseve afatshkurtra, si dhe forcimin e kulturës së mikpritjes në turizëm.

Në përfundim, anëtarët theksuan se, studime të tilla ishin shumë të vlefshme, pasi shërbenin jo vetëm për plotësimin e nevojave për aftësi, por edhe për zhvillime të mëtejshme të sektorit. Anëtarët theksuan se, arsimi dhe formimi profesional nuk mund të operonte në mënyrë të ndarë nga zhvillimet e sektorit. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme për zhvillimin e ofertës dhe praktikave profesionale. Sekretariati Teknik nënvizoi se, për sa kohë gjetjet ishin në nivel profesional, ato duhet të përktheheshin në nevoja për kualifikime. Nga pikëpamja e informacionit bazë të studimit, Sekretariati Teknik theksoi se, anëtarët duhej të identifikonin kualifikimet që duheshin rishikuar apo shtuar. Gjithashtu, nga studimi dilte informacion i rëndësishëm mbi aftësitë e munguara brenda profesioneve të caktuara, të cilat do ishin dhe fokusi i punës së Komitetit në vazhdim.